VENDIM
Nr.48, datë 21.10.2004

PËR MIRATIMIN E SASISË SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PERLLOGARITUR PËR T'U FATURUAR AFORFE PËR ABONENTËT FAMILJARË PA MATËSA PËR PERIUDHËN 1 TETOR 2004 – 31 DHJETOR 2004

Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.10.2004, gjatë shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe të Çmimeve në lidhje me aplikimin e KESH sh.a. për sasinë e energjisë elektrike të përllogaritur për t'u faturuar aforfe për abonentët familjarë pa matje,

KONSTATON SE:

KESH sh.a. gjatë vitit ka kryer faturim aforfe edhe për klientët familjarë që janë të pajisur me matje, por edhe për klientët jofamiljarë. Nuk është paraqitur numri i klientëve familjarë me faturim 0, i ndarë sa janë të pajisur me matësa dhe sa janë pa matësa. Gjithashtu, faturimi aforfe mesatar pa matje që është bërë gjatë vitit, jo në të gjitha rastet ka marrë parasysh zbatimin e përpiktë të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, duke sjellë si pasojë shkeljen e ligjit. Rritja e faturimit aforfe e propozuar per periudhen 1 tetor 2004–31 dhjetor 2004 është e pajustifikueshme duke pasur parasysh se niveli i pritshëm i kufizimeve të energjisë elektrike nga KESH sh.a. është rreth 57 % më i lartë se ai i miratuar nga ana e Qeverisë.

Prandaj, në mbështetje të ligjit nr.9072 datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 8 pika 2 germa b neni 26 pika 1, si dhe neni 52 pika 2 dhe pika 3, Bordi Komisionerëve te ERE–s,

VENDOSI :

1. Sasia e energjisë elektrike e përllogaritur për t'u faturuar aforfe për periudhën 1 tetor 2004 – 31 dhjetor 2004 të jetë sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi i Këshillit Drejtues të ERE-s nr.12, datë 29.10.2002 "Për vlerat e faturimit aforfe për konsumatorët familjarë që nuk kanë matës" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

SASIA E ENERGJISË ELEKTRIKE E PËRLLOGARITUR PËR T'U FATURUAR AFORFE PËR ABONENTET FAMILJARË PËR PERIUDHËN E DIMRIT
1 TETOR-31 DHJETOR 2004

Nr.	EMËRTIMI	QYTET	FSHAT
1	Berat	500	350
2	Bulqizë	450	250
3	Bilisht	400	200
4	Dibër	550	250
5	Durrës	500	400
6	Fier	500	350
7	Gramsh	400	200
8	Gjirokastër	450	300
9	Has	450	300
10	Kavajë	550	400
11	Kolonjë	400	200
12	Korçë	500	300
13	Krujë	450	350

14	Kuçovë	450	300
15	Kukës	550	300
16	Laç	450	300
17	Lezhë	550	350
18	Librazhd	400	200
19	Lushnjë	450	350
20	Koplik	400	300
21	Mat	450	300
22	Mirditë	550	300
23	Peqin	500	250
24	Përmet	450	250
25	Pogradec	450	200
26	Pukë	450	300
27	Sarandë	500	300
28	Skrapar	400	250
29	Tepelenë	450	300
30	Tiranë Q	600	
31	Tiranë F		400
32	Tropojë	450	300
33	Delvinë	450	300
34	Patos	450	300
35	Ballsh	450	300
36	Vlorë	500	300
37	Shkodër	500	300
38	Elbasan	500	300